



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	306/23
Nr. i fq. / Br. st	-02-
Data / Datum	15.03.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës

Bazuar në nenin 1 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 4 paragrafi 2, pika 2.4. nën-pika 2.4.3, nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 13.03.2023 merr këtë:

V E N D I M
PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHPRONËSIM TË PRONAVE TË
PALUEJTSHME

Neni 1

Fillohet procedura e shpronësimit të pronës të paluejtshme të pronarit privat/zotëruesit të interesit, për qëllim të interesit publik – realizimi i projektit ndërtimi i Kullës së Heroit Azem Galica në fshatin Galicë, Komuna Vushtri, për pjesën e parcelës kadastrale si në vijim:

- P-70202013-00423-0, në sipërfaqe prej **1590 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 21394 m², ZK-Galicë, pronar në pjesë ideale 1/1 Hetem (Hajriz) Haliti nga fshati Galicë, Komuna Vushtri.

Neni 2

Shpronësimi i pjesës të parcelës kadastrale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me kompensim, konform dispozitave të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Neni 3

Vlerësimin për kompensimin e shpronësimit e bën Zyra për Vlerësim të Pronës së pa Luajtshme pranë Ministrisë së Financave të Kosovës.

Neni 4

Me këtë vendim të njoftohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe pronari/zotëruesi i interesit të parcelës që do të shpronësohet.

Neni 5


Vendimi hyn ne fuqi në ditën e nënshkrimit nga organi shpronësues.



Kryetari i Komunës

Ferit Idrizi

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi deri në 100.00 € (njëqind euro) që Komuna do të paguajë nga fondi për transfere dhe subvencione, për secilin ndjekës të trajnimit, banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë, të cilët e përfundojnë me sukses trajnimin në SPEEEX Edukation në Vushtrri ose ndonjë kompani tjetër e licencuar e cila ushtron veprimtari të njëjtë në Vushtrri.
2. Pagesat nga pika 1 e këtij vendimi do të kryhen nga komuna për modulet si në vijim:
 - 3.1 Modulin e të mësuarit të gjuhës Gjermane apo Frënge
 - 3.2 Modulin e aftësive të komunikimit
 - 3.3 Modulin e aftësive teknik
 - 3.4 Modulin e mësimit praktik
3. Pagesa e mjeteve bëhet në llogari të secilit person që ka përfunduar me sukses trajnimin tre (3) mujorë dhe është pajisur me certifikatë nga SPEEEX Edukation në Vushtrri apo kompani tjetër legale në Vushtrri e cila ka kryer trajnime të fushave të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi, që mund të ofrojnë ofertë pune pas përfundimit të trajnimit. Pagesa bëhet në emër të personit që e ka kryer trajnimin, apo përfaqësuesit ligjorë, ose njërit prind nëse përfituesi i këtyre mjeteve është i moshës jo madhore.
4. Me rastin e aplikimit për këtë subvencion, duhet të dorëzohen në zyrën pritëse: Kërkesa e adresuar për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Certifikata valide nga kompania për kryerje të trajnimit si dhe Ekstrakti i lindjes me të cilën dëshmohet se është banor rezident i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 248/23, datë 10.03.2023.
7. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet nga data 01 janar deri më 31 dhjetor 2023. Për shkak të mbylljes së pagesave të vitit 2022 në muajin dhjetor 2022, aplikacionet e arritura për pagesë pas datës së mbylljes së pagesave, realizohen me buxhetin e vitit 2023.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr./Br 399/23

Nr. i fq./ Br. st _____

Data/ Datum 28. 03. 2023

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës lëshon këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa që të ndërmerr masa të menjëhershme bazuar në legjislacionin në fuqi, për ndalimin e lëshimit të vërtetimeve qytetarëve të cilët nuk i kanë kryer obligimet e tatimit në pronën e paluajtshme dhe taksës për mbeturina.
2. Nga Drejtori i drejtorisë në fjalë kërkoj që në fund të çdo jave të më dërgoj regjistrin e atyre që eventualisht iu kanë lëshuar vërtetime për kryerje të obligimeve e që në të vërtetë nuk i kanë kryer.
3. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet menjëherë.
4. Për mos zbatim eventual të kësaj urdhërese ndaj zyrtarëve përgjegjës kërkoj që të ndërmerren masa disiplinore në bazë të legjislacionit në fuqi.



Ferit Idrizi


Kryetar i Komunës

Urdhëresa i dërgohet:

- Drejtorit për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të sekretarisë